



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë - Ministarstva Obrazovanja Nauke i
Tehnologije -Ministry of Education Science &Technology*

KOMISIONI I PAVARUR PËR SHQYRTIMIN E MATERIALEVE
MËSIMORE NË GJUHËN SERBE

Raport Gjithëpërfshirës
24 qershor 2010
Prishtinë, Kosovë

Hyrje

Sfondi

Në bazë të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës¹ (PGJS), dhe siç është pasqyruar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës², pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë të marrin arsimim publik në njërin nga gjuhët zyrtare të Kosovës sipas preferencës së vet në të gjitha nivelet. Përveç tjerash, pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë të marrin arsimim publik parashkollor, fillor dhe të mesëm në gjuhën e tyre deri në shkallën që përshkruhet me ligj. Gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës janë gjuha shqipe dhe ajo serbe.³ Ky raport ekskluzivisht ka të bëjë me gjendjen në arsimin publik nëpër shkollat fillore dhe të mesme ku gjuha serbe është gjuhë e mësimdhënies.

Aktualisht, shkollat fillore dhe të mesme publike në Republikën e Kosovës të cilat ofrojnë mësimdhënie në gjuhën serbe shfrytëzojnë kurrikulume dhe tekste shkollore të përgatitura dhe të aprovuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) e Republikës së Kosovës, aktualisht nuk ka në dispozicion kurrikulumin ose tekstet shkollore në gjuhën serbe për shfrytëzim në shkollat fillore dhe të mesme të Republikës së Kosovës. Aktualisht MASHT-i është i angazhuar në një program gjithëpërfshirës të ripërtritjes dhe

¹ PGJS, Aneksi II, Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre, neni 3, paragrafët (b) dhe (c).

² Kushtetuta, neni 59 [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre], paragrafët (2) dhe (3).

³ Kushtetuta, neni 1 [Parimet e Përgjithshme], paragrafi 1.6. Po ashtu ekziston një dispozitë e kufizuar për përdorimin zyrtar të gjuhës turke, boshnjake dhe asaj rome në Kosovë, por kjo është jashtë fushëveprimit të këtij raporti.

reformës së kurrikulumeve dhe teksteve shkollore të shkollave fillore dhe të mesme. Puna drejt këtij qëllimi është duke shënuar progres në bazë të projekt-Kornizës së Kurrikulumit të Kosovës (KKK). Pritet që aprovimi dhe futja në përdorim e KKK-së do të çojë në përgatitjen e kurrikulumeve dhe teksteve shkollore për shfrytëzim në shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës në dobi të mësimdhënies në secilën nga gjuhët e pranuar të mësimdhënies. Kjo përfshin versionin e plotë në gjuhën serbe.

Në ndërkohë, në pritje të përfundimit të kurrikulumit dhe të teksteve të reja shkollore në gjuhën serbe mbi bazën e KKK-së, përdorimi i kurrikulumit dhe i teksteve shkollore në gjuhën serbe të përgatitura nga Republika e Serbisë do të vazhdojë të jetë i nevojshëm. Me qëllim që t'i paraprihet çfarëdo kundërshtimi sa i përket përdorimit të këtij kurrikulumit arsimor dhe materialeve për mësimdhënie, është marrë vendimi për ta rishqyrtuar këtë kurrikulum dhe materialet mësimore për përputhshmëri me legjislacionin dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Baza juridike

Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (PGJS), në Aneksin III të saj mbi Decentralizimin, e trajtoi çështjen e përdorimit të kurrikulumeve të Republikës së Serbisë. Në nenin 7 të këtij Aneksi janë dhënë dispozita në vijim:

7.1 Sa u përket planprogrameve arsimore të shkollave të Kosovës që ofrojnë mësim në gjuhën serbe:

7.1.1 Shkollat të cilat ofrojnë mësim në gjuhën serbe mund të zbatojnë planprograme apo tekste shkollore të hartuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë, me njoftim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës..

7.1.2 Në rast se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës kundërshton përdorimin e planprogramit apo tekstit shkollor të veçantë, çështja do t'i referohet një komisioni të pavarur për të shqyrtuar pajtueshmërinë e planprogramit apo tekstit shkollor në fjalë me Kushtetutën e Kosovës dhe legjislacionin e miratuar në pajtim me këtë zgjidhje.

Në këtë nen edhe më tej jepen detaje të caktuara sa i përket anëtarësisë dhe organizimit të komisionit të pavarur të cekur.⁴

PGJS-ja është inkorporuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës përmes nenit të saj 143. Si e tillë, dispozitat e lartpërmendura formojnë pjesë të rendit kushtetues të Kosovës.

Në tremujorin e parë të vitit 2009, Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, e përcaktoi sipas PGJS-së, në autoritetin e tij si interpretues përfundimtar i dispozitave të PGJ-së,⁵ konstatoi se ishte e

⁴ Në dispozitat e mëtejme organizative të nenit 7 të Aneksit III thuhet:

7.1.3 Komisioni i pavarur do të përbëhet nga tre (3) përfaqësues të zgjedhur nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që mbajnë ulëse të rezervuara apo të garantuara për komunitetin serb, tre (3) përfaqësues të zgjedhur nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës dhe një (1) anëtar ndërkombëtar i zgjedhur nga Përfaqësuesi Civil ndërkombëtar, i cili e përfaqëson atë.

7.1.4 Komisioni do t'i merr të gjitha vendimet me shumicën e votave, dhe kryesimi do të bëhet përmes rotacionit në mes të përfaqësuesit të zgjedhur nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që mbajnë ulëse të rezervuara apo të garantuara për komunitetin serb të Kosovës dhe përfaqësuesit të zgjedhur nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës çdo vit.

domosdoshme të themelojë këtë Komision të Pavarur me qëllim që aktivisht të rishqyrtohej i tërë kurrikulumi dhe tekstet shkollore në gjuhën serbe që përdoren në Kosovë për përputhshmëri me Kushtetutën e Kosovës. Ky vendim u bazua në njohjen se, në mungesë të kurrikulimit në gjuhën serbe të përgatitur në Kosovë, dhe në pritje të një kurrikulumi dhe të teksteve shkollore të reformuara sipas procesit të KKK-së, do të jetë e nevojshme të arrihet konsensusi në Kosovë lidhur me vazhdimin e përdorimit të kurrikulimit dhe të teksteve shkollore të përgatitura nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë për të siguruar të drejtën në arsim për të gjithë fëmijët, mësimi i të cilëve zhvillohet në gjuhën serbe.

Në prill të vitit 2009, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, së bashku me Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar, publikisht kanë paralajmëruar themelimin e Komisionit të Pavarur. Anëtarët janë nominuar në pajtim me nenin 7.1.3 të Aneksi III i PGJ-së. Për arsye të ndryshme, fillimi i punës së Komisionit është vonuar. Si rezultat i këtyre vonesave, një numër i personave që fillimisht ishin nominuar për t'u bërë anëtarë të Komisionit më nuk ishin në dispozicion dhe kështu është dashur të identifikohen anëtarë të rinj.

Më 10 shtator 2009, Qeveria e Kosovës e miratoi një Vendim mbi Komisionin e Pavarur.⁶ Me këtë vendim u themelua Komisioni i Pavarur, u parashtryan detyrat dhe përgjegjësitë e tij, dhe i siguronte atij mbështetje financiare.

Më 11 nëntor 2009, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e miratoi Udhëzimin Administrativ mbi Komisionin e Pavarur për Shqyrtimin e materialeve mësimore në gjuhën serbe.⁷ Ky Udhëzim Administrativ i përcaktoi Termat e Referencës dhe organizimin themelor të Komisionit të Pavarur. Në bazë të këtij Udhëzim Administrativ, janë identifikuar anëtarët e rinj për t'i zëvendësuar ata të cilët nuk ka qenë edhe më në dispozicion. Me vendim të 28 dhjetorit 2009, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e emëroi formalisht anëtarësinë e rishikuar të Komisionit të Pavarur.

Më 30 dhjetor 2009, Komisioni i Pavarur ka mbajtur mbledhjen e tij përfundimtare. Me pastaj, u themeluan edhe dy grupe punuese për të hartuar Planin e Veprimit dhe Rregulloren e Procedurës. Më 29 janar 2010, u miratua Plani i Veprimit⁸. Më 19 shkurt 2010, Komisioni i Pavarur e miratoi Rregulloren e vet të Punës,⁹ dhe më 25 shkurt 2010, ai i miratoi Modalitetet e tij Operative dhe Kriteret për Rishqyrtim.¹⁰

Fushëveprimi i këtij raporti

Ky raport është paramenduar të sigurojë një pasqyrim të plotë të punës së Komisionit të Pavarur.

Fillimisht, është shpjeguar metodologjia e punës. Pastaj, gjetjet e Komisionit janë shtruar në hollësi. Në gjetje së pari diskutohet korniza e përgjithshme e arsimit fillor dhe të mesëm sipas kurrikulimit të Republikës së Serbisë dhe marrëdhënies së tij me kurrikulumin ekzistues të Kosovës. Më pastaj, gjetjet specifike diskutohen në hollësi sipas lëndëve dhe klasëve. Në rishqyrtimin e kurrikulimit në

⁵ PGJS, Aneksi IX Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, neni 2, Mandati dhe Autorizimet e Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, paragrafi 2.1 nën (a)

⁶ Vendimi i Qeverisë së Kosovës për Komisionin e Pavarur, Nr. 08/81, data 10 shtator 2009.

⁷ Udhëzimi Administrativ Nr. 37/2009, për Komisionin e Pavarur për Shqyrtimin e Materialeve Mësimore në Gjuhën Serbe. Kini parasysh se teksti përfundimtar i këtij Udhëzimi Administrativ datohet nga 20 janari 2010.

⁸ Shih Aneksin _____ në këtë raport.

⁹ Shih Aneksin _____ në këtë raport.

¹⁰ Shih Aneksin _____ në këtë raport.

gjuhën serbe, Komisioni gjeti se në një numër të caktuar të lëndëve janë shfaqur brenga të ngjashme ose identike. Prandaj, gjetjet e detajuara janë organizuar sipas këtyre brengave të ngjashme. Secili tip i çështjes pastaj është detajuar sipas klasës, njësisë së planprogramit dhe teksteve shkollore relevante.

Të gjeturat e detajuara janë ndarë në këto kategori:

- Tesktet shkollore të lëndëve teknike dhe të tjera
- Tekstet shkollore të Gjuhës dhe Letërsisë Serbe
- Tekstet shkollore të Muzikës dhe Artit
- Tekstet shkollore të Historisë
- Tekstet shkollore të Gjeografisë

Objektivi prapa kësaj ndarje është se çdo lloj shqetësimi do të meritonte një lloj të ngjashëm të përgjigjes ose zgjidhjes.

Pjesa përfundimtare e këtij raporti ofron detaje të masave dhe veprimeve që duhet të ndërmerren nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për të siguruar konformitetin e arsyeshëm të kurrikulumeve dhe teksteve shkollore në gjuhën serbe me Kushtetutën e Kosovës dhe legjislacionin përkatës. Komisioni i Pavarur pret që përmes implementimit të këtyre masave dhe veprimeve, të mund të sigurohet vazhdimi i përdorimit në Kosovë i kurrikulumeve mësimore dhe i teksteve shkollore të hartuara nga Ministria e Arsimit të Republikës së Serbisë. Kjo do të mundësonte që të gjithë fëmijët që e ndjekin mësimin në gjuhën serbe në Kosovë do të vazhdojnë të jenë në gjendje të ndjekin arsimimin e tyre fillor dhe të mesëm pa pengesa në pritje të hartimit të kurrikulumeve dhe të teksteve shkollore në gjuhën serbe që janë plotësisht në përputhje dhe të bazuar në Kornizën e Kurrikulumit të Kosovës.

Dokumentet themelore që formuan bazën e punës së Komisionit të Pavarur janë të bashkangjitura në shtojcat e ndryshme të këtij raporti. Këto janë Plani i Veprimit, Rregullorja e Punës, Modalitetet e Veprimit dhe Kriteret e Shqyrtimit, dhe lista e të gjitha librave të rishqyrtuar.

Metodologjia

Metodologjia e përgjithshme e Komisionit të Pavarur

Komisioni i Pavarur për Rishqyrtimin e Materialeve Mësimore në Gjuhën Serbe ("Komisioni") e ka mbajtur mbledhjen e tij të parë në përbërjen e re më 30 dhjetor 2009. Që nga ajo mbledhje, Komisioni është takuar gjashtë (6) herë. Përveç tjerash, më 19 shkurt 2010, një nën-komisioni u emërua për të përgatitur materialet dhe organizimin e nevojshëm për implementimin e procesit real të rishqyrtimit. Rishqyrtimi real u zhvillua gjatë një seminari të mbajtur në Budvë, të Malit të Zi. Komisioni e finalizoi raportin gjithëpërfshirës mbi rishqyrtimin e materialeve mësimore në gjuhën serbe në mbledhjen e vet të shtatë më 24 qershor 2010.

Të gjitha vendimet e Komisionit u arritën me konsensus të plotë. Për më tepër, gjatë tërë punës së Komisionit ka mbizotëruar një klimë pozitive, me debate konstruktive dhe qasje bashkëpunuese ndaj punës së Komisionit. Kryesuesi i parë i Komisionit u zgjodh nga radhët e përfaqësuesve të përzgjedhur nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për komunitetin serb të Kosovës. Të gjitha takimet u kryesuan nga kryesuesi i Komisionit dhe në çdo mbledhje u respektua një rend dite i dakorduar. Për shkak të larmisë gjuhësore në Komision, gjuha

shqipe, serbe dhe angleze ishin gjuhët e punës gjatë mbledhjeve, dhe të gjitha materialet janë përkthyer sipas nevojës në të tria gjuhët.

Metodologjia e miratuar për rishqyrtimin e materialeve mësimore

Komisioni i ka grumbulluar të gjitha dokumentet e kurrikulumeve dhe të gjitha tekstet shkollore të përdorura në arsimin fillor dhe të mesëm në gjuhën serbe në Kosovë. Këto materiale u grumbulluan nga anëtarët e Komisionit dhe asistentët e tyre, të mbështetur nga Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave (ECMI). Të gjitha dokumentet e kurrikulumeve dhe të gjitha tekstet shkollore u grumbulluan nga burime në Kosovë.

Komisioni i ka rishqyrtuar shumicën e materialeve mësimore në gjuhën serbe, d.m.th. kurrikulumet dhe tekstet shkollore gjatë seminarit të mbajtur në Budvë, Mal të Zi, më 25-28 mars 2010. Gjatë punës së tij, anëtarët e Komisionit u ndihmuan nga anëtarët nga Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave (ECMI) si dhe një numër i vogël i ekspertëve për të cilët dha pëlqimin tërë Komisioni. Komisioni e ka përfunduar shqyrtimin e kurrikulumit dhe të teksteve shkollore në gjuhën serbe klasë pas klase në bazë të dispozitave të Modaliteteve Operative të miratuara dhe dispozitave përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjatë seminarit janë themeluar katër grupe punuese ku secila nga to ka reflektuar diversitetin e plotë të Komisionit. Kjo ka mundësuar që detyra e shqyrtimit të ndahet në bazë të klasave. Secilit grup punues i është ndarë një përzgjedhje e klasave dhe i është caktuar detyra për të shqyrtuar gjithë kurrikulumin dhe librat shkollor që shfrytëzohen për ato klasa. Grupet punuese kanë përgatitur raporte të veçanta për secilin libër shkollor dhe kurrikulum në të cilët janë paraqitur shqetësimet lidhur me kriteret shqyrtuese të dakorduara (dispozitat kushtetuese) dhe modalitetet operative.

Gjatë aktivitetit të shqyrtimit, u konstatua se një numër librash shkollor mungonte. Rrjedhimisht, puna nuk ka përfunduar plotësisht. Kurrikulumit dhe librat shkollor që mungonin janë identifikuar dhe janë siguruar, dhe pastaj ato janë shqyrtuar nga nën-komisioni gjatë muajit maj 2010. Nën-komisioni ka përgatitur draftin e parë të këtij raporti gjithëpërfshirës i cili i është paraqitur Komisionit të plotë për ndryshimet përfundimtare dhe për të arritur marrëveshjen për masat dhe veprimet tjera që do të ndërmerren.

Gjetjet – sipas çështjeve

Kurrikulumit – çështje të përgjithshme

Komisioni e ka shqyrtuar kurrikulumin e Republikës së Serbisë nga klasa 1 deri në klasën 12 dhe ka gjetur dy çështje të përgjithshme që kërkojnë vëmendje të veçantë: dallimet strukturore me kurrikulumin ekzistues të Kosovës dhe lënda e edukimit fetar. Këto dy çështje adresohen në mënyrë specifike më poshtë.

Sa i përket përmbajtjes së kurrikulumit në gjuhën serbe, ishte e vështirë për Komisionin që të bëjë referenca të drejtpërdrejta të mësimëve specifike dhe t'i gjurmojë aspektet specifike të mësimëve që nuk ishin në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Zakonisht, temat në kurrikulum janë përkufizuar gjerësisht dhe rezultatet e pritura të mësimit janë përshkruar në deklaratatë të përgjithshme. Vetëm nëpërmjet leximit të librave shkollor të një kurrikulumit të caktuar Komisioni ishte në gjendje të identifikojë dhe të bëjë referenca të drejtpërdrejta për shqetësimet lidhur me

përputhshmërinë me Kushtetutën e Kosovës. Për këtë arsye, raporti i adreson çështjet e planprogramit në përgjithësi dhe jo në mënyrë specifike klasë pas klase. Kjo është bërë për çështjet e librave të paraqitura më poshtë.

Kurrikulumi – Çështjet strukturore

Vërejtja fillestare ka të bëjë me dallimin strukturor ndërmjet sistemeve arsimore të Kosovës dhe Serbisë. Ndarja e shkollimit në fillor dhe të mesëm në Kosovës bëhet sipas modelit 5+4+3, ndërsa modeli që zbatohet në Serbi është i strukturuar sipas modelit 4+4+4.

Sistemi arsimor i Kosovës: Që nga gushti i vitit 2000 modeli i ri 5+4+3 e ka zëvendësuar strukturën 4+4+4, duke filluar nga mosha 6 vjeç. Njëkohësisht, arsimi i obliguar është zgjatur nga 8 nën 9 vite, që është në përputhje me trendet evropiane dhe ndërkombëtare të arsimimit. Rëndësi e veçantë i është kushtuar klasës 9 si klasë orientuese, në të cilën nxënësit kanë rastin që të konsolidojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre të zëna, duke kombinuar mësimet dhe aktivitetet teorike dhe praktike. Llojllojshmëria e lëndëve të reja të obligueshme dhe mësimet zgjedhore në nivelin e mesëm të ulët kanë për qëllim që të japin një shtyrje të çmueshme të aspiratave të nxënësve për karrierën e tyre dhe për t'i ekspozuar ndaj përvojave dhe sfidave të ndryshme.

Arsimi i mesëm që ofrohet në shkollat e mesme të larta përfshinë:

- Shkollat e përgjithshme (gjimnazet) – me kohëzgjatje prej tri/katër vitesh dhe ofrojnë bazat për një proces më të gjerë, më të thellë dhe më të specializuar të mësimit, përfshirë orientimin e nxënësve drejt fushave të ardhshme të interesimit dhe specializimit.
- Shkollat profesionale – me kohëzgjatje prej tri vitesh të cilat ofrojnë arsimim profesional në nivelin mesatar të certifikimit, dhe që ua mundëson nxënësve të diplomuar të hyjnë në tregun e punës menjëherë pas diplomimit, por që nuk ofrojnë automatikisht bazë për praninë në arsimin e lartë.

Në fund të arsimit të mesëm të lartë, të gjithë nxënësit duhet t'i nënshtrohen testit të standardizuar shtetëror të "maturës" nëse dëshirojnë që t'i vazhdojnë studimet në arsimin e lartë. Testi shtetëror i maturës është test me 100 pyetje me përgjigje alternative i cili mbahet dy herë në vit, zakonisht në qershor dhe në gusht, dhe nxënësit duhet të arrijnë rezultatin me përgjigje të sakta prej 50% të pyetjeve në mënyrë që me sukses ta kalojnë testin.

Sistemi arsimor i Serbisë: Kohëzgjatja e arsimit fillor (të obligueshëm) është tetë vite, që fillon nga mosha 7 vjeçare, dhe ndahet në dy cikle, secili prej tyre zgjatë katër vite. Para këtyre cikleve, periudha përgatitore e arsimit prej një viti është e obligueshme. Në Serbi zbatohet modeli 4+4+4. Arsimimi i mesëm ofrohet në shkollat e mesme ku përfshihen:

- Shkolla e përgjithshme (gjimnazi) – shkollë akademike ku nxënësit mësojnë lëndë interdisciplinare, nga lëndët shkencore e deri te ato shoqërore. Në përfundim të mësimit, ata i nënshtrohen testit të maturës që çon në marrjen e certifikatës së shkollës së mesme.
- Shkollat teknike dhe profesionale - ofrojnë shkollim dy, tre ose katër vjeçar dhe certifikatat jepen në secilin nga këto nivele. Lëndët përfshijnë ato të përgjithshme arsimore si dhe trajnimin specifik profesional.

Në shkollat e Kosovës që kanë kurrikulumi në gjuhën serbe, kurrikulumi në gjuhën serbe për arsimin fillor (klasat 1-4) përfshinë 20 orë në javë nga të cilat 9 i kushtohen mësimit të gjuhës serbe, letërsisë, artit, muzikës dhe fesë. Mësimi i historisë jepet nga klasa 5. Numri i orëve të mësimit rritet

nga 27 në 30 në klasat 5-8 dhe afërsisht një e treta e orëve u kushtohet lëndëve specifike për komunitetet "kombëtare". Ky kurrikulum zbatohet në mbarë Serbinë, pa referencë të veçantë për serbët e Kosovës. Librat shkollor nuk e përfshijnë historinë e Kosovës, por kombin serb në tërësi, dhe nuk e përfshijnë historinë bashkëkohore (periudhën nga viti 1998 deri tani) apo e mbulojnë atë vetëm nëpërmjet prezantimit të përgjithshëm të fakteve dhe datave pa hyrë në analiza. Nxënësit serbë të Kosovës kryesisht mësojnë për shqiptarët dhe historinë e tyre vetëm nga Lufta e dytë Botërore e tutje. Sa i përket gjeografisë, fëmijët mësojnë se Kosova është krahinë jugore e Serbisë në të cilën jeton kryesisht pakica shqiptare¹¹.

Reforma në sistemin arsimor të Serbisë ka filluar në vitin 2001 dhe ka hapur mundësinë për integrimin e arsimit përfshirës në strukturën e kurrikulumit duke ofruar mundësinë që shkollat ta përshtatin 30% të kurrikulumit të arsimit fillor të obliguar dhe atij të mesëm me nevojat lokale dhe nevojat specifike të nxënësve të tyre. Po ashtu, reforma është përqendruar në rezultatet e arsimit, duke hequr dorë nga fokusi i zbatimit të kurrikulumit të përshkruar të mëhershëm që ishte ekskluziv dhe i detyrueshëm me ligj. Me ndaljen e reformave nga viti 2004 e tutje, reforma e kurrikulumit gjithashtu është ndalur, dhe zbatimi i kurrikulumit të njësuar dhe të dekretuar paraprakisht është rivendosur si obligim ligjor. Rezultatet e arsimit më nuk deklarohet se janë instrument për përshtatjen e procesit arsimor me specifikat e mësimin të nxënësve të ndryshëm.

Provimi i standardizuar i obligueshëm i maturës nuk zbatohet për nxënësit që ndjekin kurrikulumin serb në Kosovë.

Kurrikulumi – Edukimi fetar

Në vitin 2001, Serbia ka zgjedhur një model të edukimit fetar që është konfesional, i ndarë, që përfshinë shumë fe i cili mësohet nga shtatë bashkësi fetare "tradicionale" ose "historike": Kisha Ortodokse Serbe (KOS), Kisha Romano-Katolike, Bashkësia Islame, Bashkësia Çifute, Kisha Evangjelike Sllave, Kisha e Reformuar Krishtere, dhe Kisha Evangjelike Krishtere në Serbi-Vojvodinë. Edukimi fetar fillimisht ishte ofruar si lëndë zgjedhore, me zgjedhje alternative të edukimit fetar ose edukimit qytetar ose asnjërin nga këto dy lëndë në klasat e para të shkollave fillore dhe të mesme. Megjithatë, në vitin 2002-2003, një rregullore e re e ka bërë të obligueshme zgjedhjen e njërës nga këto dy lëndë.

Meqë Kushtetua e Kosovës e përkufizon Kosovën si shtet laik,¹² Komisioni ka vendosur që të përjashtojë kurrikulumin dhe librat shkollorë në tërësi dhe si rezultat ato nuk adresohen si lëndë e veçantë në pjesën tjetër të dokumentit për t'u trajtuar si libra shkollor specifik që nuk përputhen me Kushtetutën e Kosovës.

¹¹ Raporti i OSBE-së për komunitetet jo-shumicë në kuadër të sistemeve arsimore fillore dhe të mesme 2009

¹² Kushtetuta e Republikës së Kosovës: Neni 8 – *Republika e Kosovës është shtet laik dhe neutral në çështjet e besimeve fetare.*

Tesktet shkollore të lëndëve teknike dhe të tjera

- Klasa: III Shkolla fillore - Natyra dhe Shoqëria
 - Libri: Natyra dhe Shoqëria, tekst për klasën e tretë të shkollës fillore, Biljana Trebjesanin, Biljana Gacanovic, Ljiljana Novkovic (2009), Beograd: Zavod za udjbenike/Instituti i Teksteve Shkollore.
 - Faqe nr. 82, 86 and 87: Përmbajtja problematike ka të bëjë me hartat e përdorura në tekstin mësimor "Natyra dhe Shoqëria". Shteti i Kosovës është paraqitur si pjesë e Republikës së Serbisë.
 - Libri: Natyra dhe Shoqëria – Fletë pune 1, Biljana Trebjesanin, Biljana Gacanovic, Ljiljana Novkovic (2009).
 - Faqe nr. 50 dhe 70: Përmbajtja problematike ka të bëjë me hartat e përdorura në tekstin mësimor "Shoqëria Natyra". Shteti i Kosovës është paraqitur si pjesë e Republikës së Serbisë.
 - Libri: Moj prvi atlas/Atlasi im i parë. Natyra dhe Shoqëria – Fletë pune 3. Jovan Ilic, Milan Danilovic, Milan Savic. (2004). Beograd: Zavod za udjbenike/Instituti i Teksteve Shkollore .
 - Faqe nr. 40-47, 49, 52-57: Përmbajtja problematike ka të bëjë me hartat e përdorura në tekstin mësimor "Natyra dhe Shoqëria". Shteti i Kosovës është paraqitur si pjesë e Republikës së Serbisë.

- Klasa: IV Shkolla fillore – Matematika
 - Libri: Radni Listovi iz Matematike za 4 razred – Milosav Marianovic, Branislav Popovic, Mariana Zelic, Alexandra mandic, 2006, Zavod za Udjbenike Beograd.
 - Faqe nr. 103: Zona gjeografike, e shprehur në kilometra katrorë, e Serbisë përfshin territorin e Kosovës - 88 361 km².

- Klasa: IV Shkolla fillore – Natyra dhe Shoqëria
 - Libri: Priroda i Drustvo - Uz 4 rad OS - Vinko Kovacevic, Branka Becanovic, 2008, KLETT.
 - Fqe nr. 6, 10, 11, 13, 18, 19, 28, 30, 33, 34, 36, 38, 40, 56, 64: Hartat, përmbajtja dhe përshkrimet përfshijnë territorin e Republikës së Kosovës si pjesë të Serbisë.
 - Libri: Proverenka – Kontrollna Sveska za Prirodu i Drustvu za 4 raz Os. Biljana Gacanovic, Bilana Trebjesanin, Lilana Novkovic, 2006, ZUB, 2006.
 - Faqe nr. 20-32; 40-46: Hartat, përmbajtja dhe përshkrimet përfshijnë territorin e Republikës së Kosovës si pjesë të Serbisë.
 - Libri: Istrazivanka - Radna Sveska uz Udjbenik Priroda I Drustva za 4 raz OS, Bilana Gacanovic, Bilana Trebjesanin, Lilana Novkovic, 2006, ZUB.
 - Faqe nr. 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41: Hartat, përmbajtja dhe përshkrimet përfshijnë territorin e Republikës së Kosovës si pjesë të Serbisë.

- Klasa: VI Shkolla fillore – Informatika dhe kompjuterët
 - Libri: Informatika dhe kompjuterët, Dragoljub Vasic, Dragan Marincic and Miodrag Stojanovic. Zavod, 2008, Beograd.
 - Faqe nr. 69: Harta e Serbisë e përdorur si ilustrim nuk e tregon Kosovën si shtet të veçantë.

- Klasa: VIII Shkolla fillore – Gjuha frënge
 - Libri: Hier at Demain – Francuski Jezik - Vesna Fila, Milica Golubovic-Tasevska, 2007, ZUB.
 - Faqe nr. 36-3: harta e Evropës dhe ajo e Republikës së Serbisë përfshijnë territorin e Republikës së Kosovës, pa e treguar Kosovën si shtet të veçantë.
- Klasa: III Shkolla e mesme – Kushtetuta dhe të drejtat qytetare
 - Libri: Ustav i Prava Gradjana- Stevan Lilic, Svetislava, Bulaic, 2006/2008 ZUB.
 - Faqe nr. 9-16: nuk ka asnjë referencë për statusin kushtetues të Kosovës;
 - Faqe nr. 130: në kontekstin e një shpjegimi i konceptit të shtetit unitar, në paragrafin 3 thuhet se Republika e Serbisë është shtet unitar me dy krahinat, atë të Vojvodinës dhe atë të Kosovës dhe Metohisë. Kjo përfshin një shpjegim shtesë për Kosovën nën sundim special ushtarak të KFOR-it dhe sundimin civil të UNMIK-ut, sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit, e prandaj teksti nuk njih pavarësinë e Kosovës që nga viti 2008;
 - Faqe nr. 136: në kontekstin e paraqitjes së autonomisë territoriale në Serbi, territori i Kosovës përmendet si krahinë autonome në kuadër të Republikës së Serbisë;
 - Faqe nr. 137 dhe 138 është dhënë një kapitull mbi "Kosovën dhe Metohinë", duke e konsideruar territorin e Kosovës si pjesë të Republikës së Serbisë;
 - Faqe nr. 164: në kuadër të prezantimit të Serbisë, pjesa mbi autonominë territoriale, në lidhje me Republikën e Serbisë, territori i Republikës së Kosovës përmendet si pjesë e Republikës së Serbisë, pra në kundërshtim me nenin 1 të Kushtetutës.

Tekstet shkollore të Gjuhës dhe Letërsisë Serbe

- Klasa: VII Shkolla fillore
 - Libri: Lexime, Milkna Andric, 2009, Beograd: Instituti i Teksteve Shkollore .
 - Faqe nr. 88: Përmbajtja problematike ka të bëjë me një poezi që përdor gjuhë të dhunshme në kontekstin e afreskut të Manastirit të Graçanicës – kjo lloj gjuhe nuk promovon parimet e lirisë dhe demokracisë. Ajo nuk nxit paqe dhe tolerancë.
 - Faqe nr. 83-87: Përmbajtja problematike ka të bëjë me një poezi që përdor gjuhë të dhunshme në kontekstin e Betejës së Kosovës – kjo lloj gjuhe nuk promovon parimet e lirisë dhe demokracisë. Ajo nuk nxit paqe dhe tolerancë.

Tekstet shkollore të Muzikës dhe Artit

- Klasa: VI Shkolla fillore
 - Libri: Kultura muzikore, Olivera Djuric, 2008, Zavod, Beograd.
 - Faqe nr. 5: përfshin himnin kombëtar serb, por jo edhe himnin e Republikës së Kosovës.
- Klasa: VII Shkolla fillore
 - Libri: Kultura muzikore, Gordana Stojanovic, Milica Rajcevic, 2009, Beograd: Instituti i Teksteve Shkollore .

- Faqe nr. 4: himni që u mësohet nxënësve është ai i Republikës së Serbisë.

Tekstet shkollore të Historisë

- Klasa: V Shkolla fillore
 - Libri: Istorija 5, S. Ferjan i , D. Stefanovi , Z. Nedeljkovi , 2007, udžbenik, odobreno.
 - Faqe nr. 57: Kapitulli "Pushtimi romak i Gadishullit Ballkanik" nuk ofron informata të mjaftueshme mbi kulturën ilire në Ballkan, as nuk akomodon historitë specifike të komuniteteve të tjera (jo-serbe). E vetmja referencë të ilirët i përmend ata si "grabitqarë".
 - Faqe nr. 76 dhe 77: Në kapitullin "Shtojcë për kuriozët" i referohet fesë së krishterë si feja më kryesore.
- Klasa: V Shkolla fillore
 - Libri: Istorija itanka saradnom sveskom, S. Ferjan i , D. Stefanovi , Z. Nedeljkovi , 2007, odobreno.
 - Përmbajtja e këtij libri mbetet i përkushtuar ndaj temave "nacionale" specifike vetëm për një komunitet. Ky libër përdor qasjen për tërë Serbinë, pa referencë të posaçme për serbët e Kosovës.
 - Ilustrimet e përdorura në libër nuk promovojnë paqe dhe tolerancë.
 - Libri përmban referenca religjioze.
- Klasa: VI Shkolla fillore
 - Libri: Istorija për Klasën e 6^{te}, Rade Mihaljcic, Zavod, 2008-2009 Beograd.
 - Mungesa e çfarëdo referencave për popullsisë ilire/shqiptare që kanë ekzistuar më parë në Kosovë, e për marrëdhëniet në mes të fiseve serbe dhe fiseve shqiptare gjatë gjithë mesjetës.
 - Faqe nr. 43: Kapitulli mbi popujt sllavë dhe popujt e tyre fqinjë përmend shumë grupe (greke, rumunë, avarë, langobardë, bavarezë, frankë, hungarezë), por jo ato ilire/shqiptare.
 - Përmbajtja e tekstit pasqyron një perspektivë ekskluzivisht serbe.
 - Faqe nr. 119: një pjesë mbi Betejën e Kosovës përmend vetëm serbë, të cilët kanë zhvilluar betejë kundër "turqve", dhe nuk përmend të gjithë popujt që ishin pjesë e "koalicionit të krishterë" të ngritur kundër sundimit osman (mysliman).
- Klasa: VII Shkolla fillore
 - Libri: Istorija za sedmi razred osnovne skole, Dusan Batakovic, 2009, Zavod za udjbenike, Beograd.
 - Faqe nr. 68: Teksti thotë se ka pasur një dëbimi të madh të popullit serb nga Kosova dhe Metohija, më 1690, dhe që më pas shqiptarët nga Shqipëria veriore dhe e mesme janë vendosur në Kosovë.
 - Faqe nr. 122 dhe 123: Aty thuhet se shqiptarët janë të ndarë në myslimanë dhe të krishterë dhe që, së bashku me myslimanët boshnjakë, ishin mbrojtës së Perandorisë Osmane në Ballkan. Teksti gjithashtu vë në dukje se ata kanë filluar të ndryshojë pas ndikimit nga bashkëkombësit e tyre nga jashtë. Teksti gjithashtu përmend rolin e Serbisë dhe Malit të Zi në luftërat ballkanike.

- Faqe nr. 174: Teksti i përmend "Serbinë e Vjetër" dhe shqiptarët si Arbanasë dhe i përshkruan ata si myslimanë të cilët u vendosën në Kosovë dhe Metohi pas vitit 1690, nga veriu i Shqipërisë.
 - Për më tepër, teksti thotë se shqiptarët vazhdimisht kishin sulmuar serbët në mënyrë që t'i dëbonin ata nga Kosova. Shqiptarët përshkruhen si plaçkitës të kishave. Referenca për këtë përshkrim bëhet në librin e Serafin Risticit (me titull "Plac stare Srbije", shtypur në Zemun, më 1864).
 - Faqe nr. 174 dhe 175: vazhdon të portretizojë shqiptarët si njerëz që kanë ushtruar dhunë kundër serbëve.
 - Përmbajtja e tekstit pasqyron një perspektivë ekskluzivisht serbe.
- Klasa: VIII Shkolla fillore
 - Libri: Istorija, Suzana Rajic, Kosta Nikolic, Nebojsa Jovanovic, 2005, ZUB.
 - Përmbajtja e këtij teksti shkollor pasqyron një perspektivë ekskluzivisht serbe mbi historinë e fundit të shekullit të 19^{te} dhe fillimit të shekullit të 20^{te}.
 - Faqe nr. 58: Lufta e shqiptarëve për çlirim dhe mbijetesë në shtëpitë e tyre në Kosovë është portretizuar si presion ndaj popullit serb në Kosovë, gjë që, sipas këtij teksti shkollor, ka nxitur Eksodin e Madhe Serb, gjatë viteve 1876-1912. Sipas burimeve historike të paanshme, ky fenomen i atribuohet më shumë zhvendosjes së popullsisë së krishterë nga territore të caktuara në kuadër të Perandorisë Osmane sesa presionit dhe spastrimit etnik të shqiptarëve ndaj serbëve.
 - Faqe nr. 183: kur paraqitet kriza e vitit 1981, demonstratat e shqiptarëve të Kosovës të vitit 1981 në Kosovë për status të barabartë të shqiptarëve dhe statusin e Republikës në kuadër të Federatës Jugosllave, prezantohet si një lëvizje për ndarjen e Kosovës nga Jugosllavia. Për më tepër, shqiptarët përmenden si minoritet, kurse në realitet ata gëzonin statusin e kombësisë, sipas Kushtetutës së Jugosllavisë e vitit 1974. Periudha nga vitit 1981 deri më 1989, dhe shtypja e intelektualëve shqiptarë dhe diskriminimi i shqiptarëve nuk prezantohen. Pezullimi antikushtetues i Autonomisë së Kosovës dhe aneksimi i Kosovës nga Serbia, më 1989, nuk përmenden në këtë libër të historisë. Kjo periudhë dhe demonstratat e vitit 1989 prezantohen me një fjali joadekuate, "si reagim ndaj ndryshimeve kushtetuese në Serbi".
 - Faqe nr. 188: Përmbajtja e këtij teksti shkollor pasqyron një perspektivë ekskluzivisht serbe mbi zhvillimet në Kosovë gjatë viteve 1998-1999.
 - Faqe nr. 189: Harta politike e Republikës së Serbisë përfshin territorin e Republikës së Kosovës.
 - Klasa: VIII Shkolla fillore
 - Libri: Istorijaska Citanka, Branka Becanovic, Biljana Stojanovic, 1993, ZUB.
 - Faqe nr. 135: Provincat autonome janë përshkruar si pjesë e Serbisë si njësi federale të Jugosllavisë, kurse krahinat Autonome kishte përfaqësimin e drejtpërdrejtë të Federatës së Jugosllavisë dhe në atë të Republikës së Serbisë.
 - Faqe nr. 137: Ngjarjet kryesore nga historia e Kosovës janë lënë anash dhe historia është paraqitur në një mënyrë të njëanshëm duke shkelur kështu Kushtetutën e Kosovës, Nenin 3.1.

- Klasa: VIII Shkolla fillore
 - Libri: Istorija, Radna Sveska- Zuzana Rajic, Kosta Nikolic, Nebojsa Jovanovic, 2006, ZUB.
 - Kjo fletë pune nuk përfshin asnjë ushtrim nga historia e Kosovës që mbulon periudhën prej 1878 deri pas Luftës së Dytë Botërore dhe historinë moderne.
 - Faqe nr. 55, 56 dhe 62: harta e Republikës së Serbisë përfshin territorin e Republikës së Kosovës.

- Klasa: II Shkolla e mesme
 - Libri: Historia, klasa 2, shkencat natyrore dhe matematike. Sima Cirkovic, 2005, Zavod Beograd.
 - Faqe nr. 75-77, 235, ...: Titulli thotë se kjo është histori e popullit të Ballkanit, ndërsa përmbajtja e diskuton vetëm për historinë e popullit serb në Ballkan. Sa i përket Betejës së Kosovës të vitit 1389: kjo është paraqitur si një betejë ekskluzivisht mes serbëve dhe turqve – askund nuk tregohet mbi pjesëmarrjen e popujve të tjerë të Ballkanit, përfshirë shqiptarët. Kur diskuton Traktatin e Shën Stefanit dhe Kongresin e Berlinit të vitit 1878, ky libër pohon se delegacioni serb donte të merrte kontrollin mbi “Serbinë e Vjetër”, duke iu referuar, mes tjerash, Kosovës, gjë që në tërë librin mbështet problemin e injorimit të përbërjes së popullsisë së këtyre zonave apo kontributin e shqiptarëve në shpërbërjen përfundimtare të Perandorisë Osmane, kurse popujt e tjerë të ndryshëm përmenden (malazezët, boshnjakët, bullgarët) me emër.
 - Nuk promovon harmoninë në mes të popullit të Kosovës, dhe nuk krijon mirëkuptim në mes të njerëzve në Kosovë.

- Klasa: II Shkolla e mesme
 - Libri: Historia, viti 2^{te} i gjimnazit dhe degës shoqërore-gjuhësore. Smilja Marjanovic-Dusanic and Marko Suica, 2005, Zavod Beograd.
 - Faqe nr. 55, 198-204, 217: Përmbajtja e tekstit shkollor pasqyron një perspektivë ekskluzivisht serbe mbi historinë nga shekulli i 6^{te} deri në shekullin e 15^{te}.
 - Faqe nr. 198-204: Rreth Betejës së Kosovës, të vitit 1389: kjo është paraqitur si një betejë vetëm në mes të serbëve dhe turqve - askund nuk tregohet mbi pjesëmarrjen e popujve të tjerë të Ballkanit, përfshirë shqiptarët.

- Klasa: III Shkolla e mesme
 - Libri: Historia për klasën 3 dhe 4 të shkollës së mesme. Kosta Nikolic, Nikola Zutic, Momcilo Pavlovic, Zorica Spadier, 2009, Beograd: Instituti i Librave Shkollore.
 - Faqe nr. 41: Teksti thotë: “Jeta për serbët u bë e padurueshme me eksodin e përditshëm në Serbi, duke u bërë një dukuri e vazhdueshme, veçanërisht në mes të viti 1878 dhe 1881, kur terrori shqiptar po rritej” [...]. Pjesa tjetër e kapitullit pohon se serbët dhe bullgarët ishin dëbuar, dhe Kosova e Maqedonia ishte populluar nga myslimanë. Në tekst më tej thuhet, “Vetëm në këtë epokë ka ndodhur një prishje e balancës etnike në mes të serbëve dhe “shqiptari” (dmth. shqiptarëve) në territorin e Kosovës e Metohisë dhe të Maqedonisë Veriore.”
 - Faqe 186 Page: përsëri përdoret termi “Shiptari”, për të treguar shqiptarët.

- Përmbajtja e këtij libri paraqet vetëm perspektivën e serbe mbi historinë e kësaj periudhe.

Tekstet shkollore të Gjeografisë

- Klasa: V Shkolla fillore
 - Libri: Gjeografia për klasën e 5, Milovan Milivojevic i Jelana Calic, 2007
 - Faqe nr. 27: Ilustrimi – përdoret harta e Serbisë, dhe Kosova nuk është e kufizuar.
 - Faqe nr. 29: Meridianët dhe paralelet në territorin e Serbisë.
 - Faqe nr. 37 dhe 49: Ilustrimet.

- Klasa: VI Shkolla fillore
 - Libri: Fletë Pune e Gjeografisë për Klasën 6, Rada Sitarica, Milutin Tadic, Instituti i Librave Shkollorë, 2008, Beograd.
 - Në përgjithësi, përdorimi i emrit Kosovë dhe Metohi, që nënkupton se Kosova është pjesë e Serbisë, në pajtim me Kushtetutën e Serbisë, ashtu sic tregohet edhe në harta të ndryshme.
 - Faqe nr. 50: "Serbia (në Kosovë dhe Metohi)". Referenca në faqen 50 qartë jep të nënkuptohet se Kosova është pjesë e Serbisë.
 - Faqe nr. 61, 63, 64, 65: harta e tregon Serbinë me Kosovën si pjesë të saj.

- Klasa: VI Shkolla fillore
 - Libri: Gjeografia për Klasën 6, Rada Sitarica, Milutin Tadic – (Zavod) Instituti i Librave Shkollorë, 2009, Beograd.
 - Përdorimi i emrit Kosovë dhe Metohi, gjë që jep të nënkuptojë se Kosova është pjesë e Serbisë në pajtim me Kushtetutën e Serbisë, ashtu sikur që tregohet edhe në harta të ndryshme.
 - Faqe nr. 90: duke iu referuar vlerësimit mbi numrin e popullsisë së Kosovës në vitin 2001, përmendet si Kosovë dhe Metohi. Harta e Serbisë përfshin Kosovën si pjesë të saj.

- Klasa: VIII Shkolla fillore
 - Libri: Gjeografia, Srbolub Dj. Stamenkovic, Dragica R. Gataric, 2007, ZUB.
 - Faqe nr. 1, 6, 7, 8, 9, 14, 29, 39, 48, 65, 100, 122, 124, 128, 148: harta e Republikës së Serbisë përfshin territorin e Republikës së Kosovës.
 - Faqe nr. 9: vendet në kufi me Serbinë përfshijë Shqipërinë dhe jo Kosovën. Hapësira gjeografike në metra katrorë e Republikës së Serbisë përfshin territorin e Kosovës.
 - Faqe nr. 13: në kontekstin e ndryshimeve gjeologjike janë përfshirë informata mbi Kosovën, e cila tregohet si pjesë e Serbisë.
 - Faqe nr. 14: në kontekstin e luginave natyrore është përfshirë lugina e Kosovës dhe ajo e hapësirës së Dukagjinit si pjesë të Serbisë. Në tekst përmendet si Kosovska i Metohijska Kotlina.
 - Faqe nr. 29-34: informatat mbi luginën e Kosovës (Kosovska i Metohijska Kotlina) janë dhënë në një kontekst të Kosovës si krahinë e Serbisë.
 - Faqe nr. 61: në kontekstin e vargjeve malore të Serbisë, malet e Sharrit paraqiten si pjesë e Republikës së Serbisë.

- Faqe nr. 100: gjatë diskutimit të burimeve energjetike, libri përfshin termocentralet e Kosovës si pjesë të sistemit energjetik të Republikës së Serbisë.
 - Faqe nr. 103: në kontekstin e prezantimit të burimeve minerale të Republikës së Serbisë, përmenden minierat e Mitrovicës dhe Kishnicës.
 - Faqe nr. 108: në kontekstin e industrisë së rëndë të Serbisë, Fabrika e Baterive në Gjilan evidentohet si pjesë e industrisë së Republikës së Serbisë.
 - Faqe nr. 114: në kuadër të prezantimit të rrjetit hekurudhor të Republikës së Serbisë, hekurudhat e Kosovës janë paraqitur si pjesë e rrjetit të Republikës së Serbisë.
 - Faqe nr. 139: në kontekstin e rajoneve gjeografike të Republikës së Serbisë, rajonet e Republikës së Kosovës paraqiten si pjesë e Republikës së Serbisë.
- Klasa: VIII Shkolla fillore
 - Libri: Geografija, Radna Sveska, ZUB, Srbolub Dj. Stamenkovic, Dragica R. Gataric, 2008, ZUB.
 - Faqe nr. 12-14: manastiret serbe në territorin e Kosovës janë paraqitur si pjesë e territorit të Republikës së Serbisë.
 - Faqe nr. 51: në kuadër të prezantimit të parqeve natyrore, Parku Natyror i Malit Sharr paraqitet si pjesë e territorit të Republikës së Serbisë.
 - Faqe nr. 92-94: në kuadër të prezantimit të Manastirit të Graçanicës dhe monumentit të Gazimestanit, këto janë të paraqitur si pjesë e territorit të Republikës së Serbisë.
- Klasa: VIII Shkolla fillore
 - Libri: Geografska Citanka, Stevan M. Stankovic, 2005, ZUB.
 - Faqe nr. 5, 9, 13, 15, 18, 20, 22, 24, 27, 30, 33, 36, 38, 45, 52, 53, 56, 58, 59, 62, 64, 71, 74, 75, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 86, dhe 87: këto faqe përmbajnë harta të Republikës së Serbisë që përfshijnë territorin e Republikës së Kosovës.
 - Faqe nr. 17: në kontekstin e ushtrimeve për llogaritjen e zonës së luginave, në metra katror, ushtrimi mbi llogaritjen e luginës së Kosovës është dhënë si pjesë e Republikës së Serbisë.
- Klasa: II Shkolla e mesme
 - Libri: Gjeografia për Vitin e 2^{të} të Gjimnazit. Vladimir Djuric, 2007, Beograd, Instituti i Librave Shkollore.
 - Faqe nr. 50, 124, 126, 136, ...: të gjitha hartat dhe referencat gjeografike në lidhje me Kosovën janë politike, ku Kosova tregohet si pjesë e Serbisë.
 - Pas bombardimeve të NATO-s, të citit 1999, libri pohon se më shumë se 230.000 serbëve dhe jo-shqiptarë janë larguar nga Kosova.
 - Kur përmendet numri i pjesëtarëve të pakicave, të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovë janë llogaritur si pjesë e Serbisë.
- Klasa: III Shkolla e mesme
 - Libri: Gjeografia për Gjimnaz, Mirko Grcic, Stevan Stankovic, Liljana Gavrilovic, Svetlana Radovanovic, Milomir Stepic, Snezana Djurdjic, 2008, Beograd: Instituti i Librave Shkollore.
 - Faqe nr. 8 dhe 9: me rastin e përshkrimit të Kosovës, ky tekst shkollor ende e konsideron Kosovën si pjesë të Republikës së Serbisë. Për më tepër, ai flet

- për UÇK-në si një organizatë të paligjshme. Fotografia e dhënë tregon njerëz që pohojnë se Kosova i përket Serbisë (parulla: "Kosova mbetet e jona").
- Faqe nr. 11, 20 dhe 21: harta e Serbisë përfshin Kosovën. Teksti i kësaj pjese përfshin Kosovën si pjesë të Serbisë.
 - Faqe nr. 12: përmend Kosovën dhe Metohinë e madhe.
 - Faqe nr. 14: harta e Serbisë përfshin Kosovën.
 - Faqe nr. 15: paragrafi që përmend Kosovën dhe Metohinë jep të nënkuptohet se fuqitë e mëdha ndërkombëtare kanë pasur interes në çështje brenda Serbisë për të mbështetur pavarësinë e pakicës shqiptare në Kosovë dhe Metohi.
 - Faqe nr. 17, 18 dhe 19: paragrafi që u referohet kufijve nuk përfshin kufijtë e Kosovës.
 - Faqe nr. 19: paragrafi pranon se Kosova ishte nën administrim ndërkombëtar pas vitit 1999, por përmend se komuniteti ndërkombëtar dështoi në qëllimin e tyre për të sjellë paqe dhe garantuar kontrollin e kufirit.
 - Faqe nr. 36: Kosova përmendet si pjesë e Serbisë.
 - Faqe nr. 40, 41, 44, 62 dhe 72: hartat – Serbia përfshin Kosovën si pjesë të saj.
 - Faqe nr. 48, 50, 53-57, 60, 61, 68, 69: përshkrimi e lumenjve, liqeneve e maleve, bimësisë dhe elementeve të tjera gjeografike të Kosovës e tregon Kosovën si pjesë të Serbisë.
 - Shënim: ky tekst shkollor është rishikuar plotësisht deri në faqen 80, por edhe pjesa tjetër e tij është përplot me referenca për Kosovën si pjesë të Serbisë, sa i përket përmbajtjes dhe hartave.

Masat dhe veprimet që duhen ndërmarrë

Çështjet rreth kurrikulumit

Çështjet strukturore

Komisioni konsideron që është thelbësore të ketë një system unik arsimor që është i vlefshëm për të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komisioni nuk ka gjetur shumë fusha problematike lidhur me përmbajtjen e kurrikulumit, por shqetësimi kryesor mbetet struktura e kurrikulumit dhe modelet krejtësisht të ndryshme që zbatohen në Kosovë dhe në Serbi (modeli 5+4+3 në Kosovë dhe modeli 4+4+4 në Serbi). Pasi që Qeveria e Kosovës nuk mund të ndikojë për të bërë ndonjë ndryshim në sistemin arsimor të Republikës së Serbisë, Komisioni propozon që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) e Kosovës të zhvillojë një kurrikulum të plotë në gjuhën serbe që është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe Kornizën e Kurrikulumit të Kosovës.

Në pritje të zhvillimit të një kurrikulumi të Kosovës në gjuhën serbe, MASHT duhet të përgatisë një provim të standardizuar të maturës pas klasës së 12 në gjuhën serbe për nxënësit në Kosovë të cilët e kanë gjuhën serbe si gjuhë të të mësimdhënies. Ky provim i përkohshëm i maturës do të bazohet

në kurrikulumin ekzistues që është në përdorim në gjuhën serbe, duke shmangur çështjet problematike të identifikuara nga Komisioni.

Edukata fetare

Kjo lëndë nuk është në pajtueshmëri me Nenin 8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila e përcakton Kosovën si shtet laik. Prandaj, mësimi i kësaj lënde në shkollat publike në Kosovë është hedhur poshtë plotësisht nga ana e Komisionit. Zgjidhja do të jetë pjesë e tërë procesit të zhvillimit të kurrikulumit që duhet të ndërmerret nga MASHT-i. Kurrikulumi në gjuhën serbe dhe tekste që do të zhvillohen nga MASHT-i nuk do të përfshijnë Edukatën Fetare si pjesë të sistemit arsimor publik në Republikën e Kosovës.

Në pritje të zhvillimit të një kurrikulumi të Kosovës në gjuhën serbe, MASHT duhet të vendosë që të mos financojë mësimin e edukatës fetare nga mësimdhënësit që punojnë në shkollat në Kosovë.

Çështjet rreth teksteve shkollore

Tekstet shkollore teknike dhe të tjera

Siç është përmendur në pjesën e gjetjeve për secilën çështje, çështjet kryesore problematike në këto tekste shkollore janë hartat në të cilat tregohet Kosova ende si pjesë e Serbisë. Duke pasur parasysh se nuk është e mundur për t'iu drejtuar botuesve të teksteve shkollore në Serbi që të botojnë versione të rishikuara të teksteve ekzistuese shkollore, Komisioni propozon që MASHT-i të shpërndajë dhe të udhëzojë shkollat që t'i vendosin hartat e Kosovës në vende të dukshme në të gjitha shkollat dhe klasat ku nxënësve u jepet mësim bazuar në kurrikulumet e Serbisë dhe me tekste shkollore të sjella nga Serbia.

Duke marrë parasysh mungesën e materialeve mësimore mbi sistemin kushtetues të Kosovës dhe të drejtat e qytetarëve të Kosovës në kurrikulumin serb të edukatës qytetare, Komisioni propozon që MASHT të zhvillojë dhe shpërndajë materiale mësimore në gjuhën serbe mbi Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e poashtu të udhëzojë shkollat dhe mësimdhënësit mbi përdorimin e këtij materiali.

Tekstet shkollore të gjuhës dhe letërsisë serbe

Dy çështjet problematike të identifikuara nga Komisioni në tekstin shkollor të Klasës 7 kanë të bëjnë me dy poezi të përfshira në tekstin e letërsisë. Komisioni propozon që MASHT-i të udhëzojë mësimdhënësit e Klasës 7 që të mos i përdorë këto dy poezi¹³ kur t'u jepen mësim nga letërsia serbe nxënësve në Kosovë.

Tekstet e artit dhe muzikës

¹³ Poezitë në fjalë janë: (1) "Beteja e Kosovës" nga Ljubomir Simovi , faqe 83-87, dhe (2) "Simonida" nga Milan Raki , faqe 88.

E vetmja e gjetur Komisionit në tekstet e muzikës dhe artit ka të bëjë me tekstet që përdoren në klasat 6 dhe 7, të cilat që të dyja përmbajnë Himnin Kombëtar të Republikës së Serbisë. Duke pasur parasysh se serbët e Kosovës kanë të drejtë për shtetësi të dyfishtë, Komisioni propozon që MASHT-i të përgatisë dhe t'u shpërndajë mësimdhënësve të muzikës në klasat 6 dhe 7 një njësi mësimore mbi Himnin Kombëtar të Kosovës për përdorim me rastin e mësimit të muzikës nxënësve në Kosovë të cilët ndjekin mësim me kurrikulumin dhe tekste shkollore në gjuhën serbe.

Tekstet e historisë

E gjetura kryesore e Komisionit ka të bëjë me përfaqësimin e komuniteteve të ndryshme që përbëjnë popullsinë që ka qenë e pranishme në territorin e Kosovës gjatë së kaluarës. Kjo gjetje ka të bëjë me tekstet që përdoren nga 5 klasa e shkollës fillore e deri në klasën 4 të shkollës së mesme. Shkaku kryesor i kësaj të gjeture është se tekstet e zhvilluar nga Republika e Serbisë përshkruajnë historinë e popullit serb, e jo historinë e territorit të Serbisë dhe Kosovës në kohën moderne. Si rezultat, dalin një sërë çështjesh të diskutueshme në lidhje me interpretimin e ngjarjeve historike ashtu siç shihen ato nga komunitetet e ndryshme që jetojnë në Kosovë në ditët e sotme.

Duke pasur parasysh rëndësinë e zhvillimit të marrëdhënieve harmonike dhe paqësore midis komuniteteve të ndryshme që jetojnë në Kosovë, Komisioni e konsideron thelbësore që të zhvillohet një kurrikulum i historisë që reflekton shumëllojshmërinë kulturore të Kosovës. Prandaj, Komisioni propozon që MASHT të zhvillojë një kurrikulum të plotë në gjuhën serbe, dhe të gjitha tekstet përkatëse, që trajtojnë tema historike në një mënyrë që është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe Kornizën e Kurrikulumit të Kosovës.

Komisioni ka vënë re se gjerësia dhe thellësia e kësaj çështjeje duhet të balancohet me nevojën për të siguruar që fëmijëve në Kosovë të cilët ndjekin shkollimin e tyre në gjuhën serbe të vazhdojë t'u ofrohet arsimim publik në pritje të zhvillimit të zgjidhjeve adekuate.

Për këtë qëllim, Komisioni propozon që MASHT të përfshihet në dialog konstruktiv me edukatorë dhe pedagogë shqiptarë dhe serbë të Kosovës dhe komuniteteve të tjera në Kosovë, në mënyrë që të nxirren ide dhe të stimulohet drejt zhvillimit të kurrikulumit dhe të teksteve me tema historike.

Si një masë e përkohshme në pritje të zhvillimit të kurrikulumit dhe teksteve të reja shkollore në gjuhën serbe që do të ishin në pajtueshmëri të plotë me ato që u cekën më sipër, Komisioni propozon që MASHT t'i udhëzojë mësimdhënësit e historisë që përdorin kurrikulumin dhe tekstet e Serbisë për klasat 5, 6, 7, 8 të shkollës fillore, dhe klasat 2 dhe 3 të shkollës së mesme, që me rastin e përgatitjes dhe dhënies së njërive mësimore të marrin parasysh gjetjet e Komisionit për secilin tekst shkollor.

Tekstet e gjeografisë

Gjetjet kryesore të Komisionit në lidhje me tekstet e Gjeografisë që përdoren përgjatë tërë shkollimit fillor dhe të mesëm kanë të bëjnë me hartat e përdorura dhe përshkrimet e karakteristikave

gjeografike që e paraqesin Kosovën si pjesë të Republikës së Serbisë. Duke pasur parasysh se nuk është e mundur për t'iu drejtuar botuesve të teksteve në Serbi për të botuar versione të rishikuara të teksteve ekzistuese, Komisioni propozon që MASHT-i të shpërndajë dhe udhëzojë shkollat që të vendosin hartën e Kosovës në vende të dukshme në të gjitha shkollat dhe klasat ku nxënësve u jepet mësim bazuar në kurrikulumet e Serbisë dhe me tekste shkollore të sjella nga Serbia.

Komisioni vë re se gjithashtu ka gjetur se tekstet e Gjeografisë nuk japin një paraqitje të balancuar të fakteve dhe shifrave kur është fjala për të përshkruar Kosovën. Komisioni propozon që MASHT të ketë parasysh nevojën për të siguruar një paraqitje të balancuar të fakteve dhe shifrave gjeografike me rastin e zhvillimit të një kurrikulumi të plotë në gjuhën serbe që është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe Kornizën e Kurrikulumit të Kosovës.

Publikimi i Raportit

Komisioni propozon që Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e publikon këtë raport gjithëpërfshirës në të tri versionet gjuhësore – shqip, serbisht dhe anglisht.